



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:045726

Datë: 20.01.2025

Numri i dokumentit: 06730895

KF.nr.789/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, gjyqtarja Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Autosalloni 03 Group”, me seli në Pejë, përfaqësuar nga Besim Curri Avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekti i kontestit - origjina e mallit, vlerë e kontestit 2,726.73 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 13.01.2025, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Besim Curri Avokat dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur M. K., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Autosalloni 03 Group”, me seli në Pejë.
- II. ANULOHET Aktvendimi me nr. 01.3.2.2/24184, 261 i datës 19.01.2022, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Autosalloni 03 Group”, me seli në Pejë t’ia kthej shumën prej 2,310.79€ në emër të taksës doganore dhe shumën prej 415.94€ në emër të TVSH-së, gjithsejtë 2,726.73 € (dy mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë euro e shtatëdhjetë e tre cent), për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-2554/15.02.2021, R-7189/26.07.2021, R-7131/13.04.2021, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Autosalloni 03 Group” përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 01.03.2022, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit 01.3.2.2/24184, 261 të datës 19.01.2022, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit Doganor dhe Ligjit për Procedurën Administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë të gjitha pretendimeve të paraqitura në padi derisa më tutje sqaroi se në rastin konkret bëhet fjalë për verifikimin e dokumenteve të origjinës EUR1 i cili zakonisht si verifikim bëhet nga shteti prej nga vjen automjeti e me kërkesën e autoritetit doganor ku automjeti është i importuar. Pra në rastin konkret Dogana e Kosovës ka dërguar një dokument dhe autoritetet franceze kanë pasur ose kanë mundësi që të kthejnë tri përgjigje. Përgjigja e parë në shumicën e rasteve që kthehet është pozitive dhe kjo ceket decidivisht në përgjigje ku thuhet përgjigja është pozitive, malli fiton origjinën preferenciale, përgjigja e dytë thuhet negative-malli nuk fiton origjinë preferenciale dhe përgjigja e tretë është kjo që kemi në rastin konkret e ku decidivisht thuhet verifikimi i origjinës nuk është i mundur. Pra e paditura këtë përgjigje të autoritetit doganor francez e konsideron si negative për kundër se thuhet qartë se verifikimi i origjinës nuk është i mundur të bëhet. Figurativisht kjo nënkupton se e paditura rezultatin baraz në një ndeshje futbollistike, po e konsideron fitore. Por në aspektin ligjor vlen ose do të duhej të vlejë parimi i mirënjohur juridik “in dubio pro reo” që më tutje nënkupton në rast të dyshimit vendoset në favor të palës. Tutje gjykatën e njofton se në një rast paraprak i cili është 100% i njëjtë, kjo gjykatë ka vendosur në favor të palës, me numër të lëndës KF.nr.348/2022 i datës 20.03.2024 i cili është sjellë bazuar edhe në precizimin e kërkesëpadisë që është bërë nga ana e paditësit. Më tej ka theksuar se e paditura përkundër faktit se ka obligim ligjor që këto përgjigje t’i dorëzojë paditësit një veprim të tillë nuk e ka bërë, përkundër kërkesës decidive që ka pasur në kërkesën e paditësit, duket shtuar se janë të sigurt se vetëm kjo shkelje si e tillë mjafton ose do të duhej të mjaftonte për aprovimin e kërkesës së paditësit, gjithmonë nëse kemi parasysh se ligji i përgjithshëm i procedurës administrative në nenin 92 të saj decidivisht parasheh obligimin e organit publik që palës në kontest gjithmonë t’i dorëzoj provat dhe atë në afatin pesë ditor kurdo që ajo kërkon. Duke theksuar se këtë e thonë për shkak se në rast se ne do të ishin të informuar me përgjigjen e autoriteteve doganore të shtetit eksportues nëpërmes përfaqësuesit tonë në Francë do të mund të kërkonim që përgjigja të jetë ose pozitive ose negative, sidomos nëse kemi parasysh se në rastin konkret bëhet fjalë për automjet të tipit Golf e që botërisht dihet

se është prodhim i shtetit gjerman, por sido që të jetë edhe me ligjin e procedurës kontestimore dhe atë të procedurës së përgjithshme administrative faktet e ditura botërisht ose ato të pezulluara nuk do të duhej të vërtetohen pasi ato janë botërisht të ditura. Gjykatë i ka propozuar që padinë të aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e precizuar, duke obliguar të paditurën që t'i kthehen paditësit mjetet e paguara më tepër me rastin e zhdoganimit të mallit në shumë prej 2,726.73€ përkatësisht në emër të taksave doganore 2,310.79€ dhe në emër të TVSH 415.94€.

E paditura në përgjigje në padi të datës 13.09.2024 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pabazuar dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i palës së paditur ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktvendimit kontestues duke konsideruar se ky vendim është tërësisht i drejtë dhe i ligjshëm dhe i bazuar në prova. Pretendimet e paditësit se vendimi është marrë me shkelje ligjore nuk mund të mbështet me asnjë provë të vetme relevante juridike. Më tej ka shtuar se përfaqësuesi i paditësit sqaroi shumë mirë se çka është EUR1 dhe kur subjekti lirohet apo e gëzon këtë të drejtë të lirit. Në pjesën e përgjigjes që Dogana e Kosovës e ka marrë nga Dogana Belge është sqaruar se importuesi për të dyja rastet nuk e gëzon të drejtën e trajtimit preferencial, pra që nënkuptojnë në bazë të këtij EUR nuk mund të lirohet nga taksat e doganës. Gjithashtu si në paragrafin më lart sqarohet se në bazë të këtyre kushteve dhe marrëveshjes për stabilizim dhe asociim në mes të Kosovës dhe EU dhe rregullave që i përcakton Konventa Pan evropiane nuk janë të mundshme plotësimi i kushteve të origjinës së mallit. Andaj konsideron edhe një herë se dogana ka vepruar drejtë dhe se vendimi duhet të mbetet në fuqi. Konsideron se asnjë rast nuk është i njëjtë, secili rast i ka provat e veta andaj edhe secili rast duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë, prandaj jemi në proces gjyqësor dhe njoftojë gjykatën se të gjitha këto raste janë në procedurë të ankesës. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj kërkesëpadinë si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin e të paditurës si të drejtë dhe të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor gjyqësor-publik të datës 13.01.2025, ka administruar provat si në vijim: Aktvendim nr. 01.3.2.2/24184,261 datë 19.01.2022, Dy përgjigje nga Dogana Belge datë

07.10.2021, EUR 1 me nr. E5.850.046 dhe me numër E5.850.054, Ankesë datë 08.12.2021, Aktvendim 03.1.1-2021-313 datë 02.12.2021 dhe 03.1.1-2021-320 i datës 02.12.2021, Shkresë e paditësit për plotësimin e lëndës dorëzuar në doganë e datës 18.01.2022, Listë distribuimi e datës 03.12.2021 dhe 14.01.2022, Kërkesë e paditësit për rishqyrtim e datës 06.01.2022, Kërkesë për verifikimin e EUR 1 datë 19.02.2021, Përgjigje nga Dogana Belge datë 28.09.2021, Kërkesë për verifikimin e EUR datë 25.01.2021, Shkresë e datës 10.11.2021 lidhur me rezultatet e post verifikimit të certifikatave EUR 1, DUD R 4377 datë 23.01.2021 dhe DUD R 24578 datë 12.12.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se subjekti “Autosalloni 03 Group” ShPK, përmes Deklaratës unike doganore R2554/15.02.2021, R7189/26.07.2021, R7131/13.04.2021 në procedurë IM4 ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor me preferencë MSA, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu, nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që paditura e ka kontestuar preferencën MSA të deklaruar nga paditësi, ashtu që Sektori për Kontrollë pas Importuese përmes aktvendimit nr. 03.1.1-2021-313 dhe aktvendimit nr. 03.1.1-2021-320, ka obliguar këtu paditësin me taksa shtesë. Jo kontestuese mbetet edhe fakti se paditësi ka ushtruar kërkesë për rishqyrtimin e vendimeve të lart cekura tek e paditura e për të cilat e paditura ka nxjerr aktvendimin 01.3.2.2/24184,261 me të cilin e ka refuzuar kërkesën e paditësit, e ndaj të cilit paditësi me padinë e datës 08.03.2022 ka inciuar këtë konflikt tregtar administrativ.

Kontestuese ndërmjet palëve mbetet nëse përgjigja e autoriteteve belge duhet të konsiderohet si përgjigje negative në lidhje me kualifikimin e trajtimit preferencial.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se Sektori i Kontrollit pas importues ka vepruar drejtë kur duke vepruar sipas detyrës zyrtare si dhe duke u bazuar në shënimin e brendshëm të Sektorit të Origjinës me nr.04.1.1-05/05.01.2021 ka ushtruar kontroll dokumentar për importin R-7131/13.04.2021, në

procedurë IM4, të subjektit në procedurë dhe ka konstatuar se pa të drejtë e ka shfrytëzuar normën e preferencës së origjinës MSA përmes EUR1, nr. E5.850.054 nga shteti dërgues Gjermania. Po ashtu edhe përmes Shënimit të Brendshëm të Sektorit të Origjinës me nr.04.1.1-17/21/19.02.2021, ka ushtruar kontroll dokumentare për importet R25541/15.02.2021, R-17189/26.07.2021 me procedurë IM4 të subjektit në procedurë, dhe ka konstatuar se pa të drejtë e ka shfrytëzuar normën e preferencës së origjinës MSA, përmes EUR 1 nr.E5.850.046 dhe E5.863.286 nga shteti dërgues Belgjikë. Deri te një konstatim i tillë ka ardhur gjatë analizave të bëra dhe duke u bazuar në shkresat e Sektorit të Origjinës me nr.05/21/05.01.2021 dhe nr.04.1.1-17/21/19.02.2021, ku Sektori i Origjinës ka kërkuar nga autoritetet doganore belge që të bëjë verifikimin e certifikatave të origjinës EUR1 me nr.E5.850.054, EUR1 nr.E5.850.046 dhe EUR1 nr.E5.863.286, të prezantuara me rastin e zhdoganimit të mallit, se a i plotësojnë kushtet për certifikatë preferenciale për automjetet nga eksportuesi “Christ Matrix Automobile 53879 Euskirchen/De, Christ Mart Automobile H.Klemm Schleichthofsrahe 691126 Schwabach/De. Sektori i origjinës ka pranuar përgjigje negative nga Autoritetet Doganore Belge lidhur me deklaratimet e origjinës preferenciale, ku është cekur se në bazë të procedurës së post verifikimit është konstatuar se automjetet sipas certifikatave të cekura më lart nuk i plotësojnë kriteret për tu trajtuar me origjinë preferenciale. E paditura vendimin e ka mbështetur në nenin 82 par 3 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës me arsyetim se provat e siguruar nga verifikimi nga autoritetet doganore Belge, janë prova të mjaftueshme, dhe se obligimi për pagesë të taksave shtesë nga Sektori i Kontrollës pas Importuese është në harmoni me të gjeturat dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata në rastin konkret nuk mund të pajtohet me vërtetimin e gjendjes faktike të paditurës dhe qëndrimin juridik të dhënë në arsyetimin e aktvendimit kontestues, për arsye se e paditura fare nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike me të cilin dëshmohet se malli lëndor kontestues nuk i plotëson kriteret për tu pranuar si mall me origjinë preferenciale. Prandaj gjykata vlerëson se në rastin konkret e paditura gabimisht ka vendosur kur ka bërë ndryshimin e të dhënave për Deklaratat Unike Doganore R-7131/13.04.2021, R-25541/15.02.2021, R-17189/26.07.2021 në procedurë në kuptim të preferencës, duke e obliguar subjektin në procedurë që të paguajë detyrime shtesë në vlerë prej 2,726.73€, kjo për faktin se subjekti në procedurë ka prezantuar prova të mjaftueshme për të vërtetuar origjinën preferenciale të mallit, respektivisht ka prezantuar EUR1 me nr.E5.850.054, EUR1 nr.E5.850.046 dhe EUR1 nr.E5.863.286, me të cilët vërtetohet origjina preferenciale e mallit. Ndërsa konfirmimi nga autoritetet belge e cila nga e paditura është vlerësuar si e mjaftueshme për ndryshimin e të dhënave doganore dhe obligimin

e këtu paditësit për pagesën e tatimeve shtesë, për gjykatën nuk paraqet bazë për veprimin e të paditurës, kjo për faktin se i njëjti sqaron se konfirmimi nuk është i mundshëm për shkak të mungesës së bashkëpunimit dhe provave mbështetëse të ofruara nga agjenti doganor i eksportuesit (i cili ka aplikuar për certifikatën dhe për këtë arsye është përgjegjës për mbajtjen e provave preferenciale të origjinës), e që për gjykatën kjo nuk paraqet përgjigje negative siç është interpretuar nga e paditura. Aq më tepër kur nga përgjigja e autoritetit belg kuptohet se për këtë moment nuk kualifikohet malli për trajtim preferencial dhe jo si është arsyetuar në vendimin kontestuese se vetura sipas certifikatës së cekur nuk i plotësojnë kriteret për tu trajtuar me origjinë preferenciale.

Gjykata cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pakontestueshëm nga pikëpamja ligjore për njohjen e origjinës preferenciale për mallin kontestues konform dispozitave ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b ,të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46,paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe anulojë aktvendimin e kontestuar të paditurit duke obliguar të njëjtin që paditësit t’ia kthej shumën 2,310.79€ në emër të taksës doganore dhe shumën prej 415.94€ në emër të TVSH-së, gjithsejtë 2,726.73€.

Ligji Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1 përcakton se:“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim” ,paragrafi 2. “Me aktgjykim padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”. Paragrafi 3. “Nëse padia aprovohet ,gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”, paragrafi 4. “Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet ,mundet ,nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë ,me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar dhe paragrafi 5. “Me aktgjykim ,me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ ,gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit ,nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën gjykata do të udhëzojë paditësin që kërkesën e vet të realizojë në procedurën kontestimore”

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës ,Gjykata e ka marr konform nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform nenit 43, par 1 dhe 46 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.789/22, datë 13.01.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.